



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Performancës

EFIKASITETI I SHËRBIMIT SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR TË KOSOVËS NË NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË KLINIKËS SË ORTOPEDISË



Prishtinë, gusht 2025

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000¹) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë², efikasitetit³ dhe efektivitetit⁴ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit “Efikasiteti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës në ndërtimin e i objektit të Klinikës së Ortopedisë” në konsultim me Ndhmës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Arben Selimi, Drejtor i departamentit

Edona Abazi (Udhëheqëse e ekipit),

Gazmend Namani (Anëtar i ekipit)

¹ Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

² Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

³ Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

⁴ Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	5
1 Hyrje	8
2 Objektivi dhe pyetjet e auditimit.....	9
Pyetjet e auditimit	9
3 Gjetjet e auditimit	10
Mangësitë e planifikimit fillestar dhe procedurat e prokurimit jo në përputhje me kërkesat ligjore kanë ndikuar në performancën e projektit	11
3.2 Jo efikasitet në menaxhimin dhe monitorimin e projektit	19
4 Konkluzionet.....	23
5 Rekomandimet.....	25
Shtojca 1. Motivi i auditimit, kriteret, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia.....	26

Lista e shkurtesave

LPP	Ligjit për Prokurimin Publik
MSh	Ministria e Shëndetësisë
OE	Operatori Ekonomik
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RrUOPP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik
ShSKUK	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Ndërtimi i klinikës së Ortopedisë në QKUK është vlerësuar si një nevojë urgjente dhe e domosdoshme për shkak të sfidave të shumta me të cilat është përballur sistemi shëndetësor në këtë fushë. Hapësirat që i posedonte klinika e Ortopedisë nuk i përmbushnin nevojat për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e aktiviteteve të nevojshme profesionale mjekësore.⁵ Për të ofruar një shërbim më efikas, më të sigurt dhe në përputhje me standardet bashkëkohore të mjekësisë, ndërtimi i kësaj klinike është vlerësuar si një hap i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të kujdesit shëndetësor për qytetarët.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës me temën “Mbindërtimi dhe zgjerimi i objektit ekzistues të Klinikës së Ortopedisë në QKUK”. Objektivi i këtij auditimi ishte të vlerësojmë nëse ShSKUK ishte efikase në menaxhimin e projektit për ndërtimin e kësaj klinike. Auditimi ka vlerësuar të gjitha fazat e projektit, duke filluar me identifikimin e nevojave, zhvillimin e procedurave të prokurimit, menaxhimin e kontratave dhe monitorimin e duhur të performancës së kontratës për t’u siguruar që projekti është përfunduar në kohë, me çmimin e kontraktuar dhe sipas specifikacioneve teknike.

Ky projekt ka sjellë përmirësime të mëdha në infrastrukturë dhe pajisje, duke krijuar kushte të mira për pacientët dhe funksionim të rregullt të klinikës. Këto ndryshime sigurojnë efikasitet dhe cilësi të qëndrueshme në shërbime. Megjithatë auditimi ynë ka nxjerrë në pah një numër të konsiderueshëm të parregullësive që tregojnë se ShSKUK nuk ka qenë efikase në menaxhimin e këtij projekti. Kjo kishte ndodhur për shkak se projekti nga fillimi e deri tek përfundimi ka zgjatur afër pesë vite, përderisa ishte planifikuar të kryhej për një vit e gjysmë. Në këtë vonesë ka ndikuar planifikimi jo i duhur i projektit, mungesa së një analize të hollësishme të nevojave reale dhe burimeve të kërkuara. Për më tepër, janë evidentuar mangësi të konsiderueshme në menaxhimin e kontratës, si në aspektin e mbikëqyrjes së zbatimit të punëve, ashtu edhe në adresimin me kohë të pengesave të hasura gjatë realizimit.

Këto dobësi kanë rezultuar në vonesa të konsiderueshme në përmbylljen e projektit dhe mosrealizim të objektivave të parashikuara brenda afateve të përcaktuara, që ka ndikuar edhe në mos ofrimin me kohë të shërbimeve për pacientë.

Mangësitë e planifikimit fillestar dhe ndikimi i tij në realizimin e projektit

Projekti në fjalë ka hasur në një sërë pengesash të ndërlidhura mes vete, shkaktuar nga hartimi i kërkesës iniciuese jo mirë të analizuar dhe një planifikimi fillestar të bazuar në analiza jo të plota dhe të pa verifikuara në terren. Si rrjedhojë, i gjithë procesi i realizimit të këtij projekti është karakterizuar me parregullsi, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë, kohëzgjatjen dhe efikasitetin e realizimit të tij, si:

- Në fillim të planifikimit, ishte paraparë që ndërhyrja të përfshinte renovimin e objektit ekzistues, dhe pas kësaj ngritjen e një kati shtesë dhe zgjerimin e hapësirave përmes një aneksi të ri. Mirëpo, pas inspektimeve të detajuara në terren, është vërejtur se objekti nuk i përmbushte kushtet për ndërhyrjet e planifikuara, gjë që ka pasuar me demolimin e tij dhe rikonceptimin e projektit.

⁵ Raporti vjetor i klinikës së Ortopedisë për vitin 2019

- Pas kësaj, në vitin 2019 është lidhur kontrata për realizimin e punimeve, me afat përfundimtar të parashikuar në janar 2021. Gjatë zbatimit të kontratës, kompania punë-kryese ka identifikuar mangësi në projekt, përkatësisht pozicione të papërshtatshme për kushtet e kërkuara në klinikë, duke bërë të domosdoshme ndryshimin e një numri të konsiderueshëm të tyre. Si rrjedhojë, janë ndaluar punimet për të bërë vlerësimin e situatës dhe zhvillimin e procedurave të reja të prokurimit. Kjo procedurë ka rezultuar me lidhjen e një kontrate shtesë *për punë të paparashikuara* me të njëjtën kompani, duke shtyrë më tej afatin kohor për përfundimin e projektit dhe njëkohësisht duke rritur koston e tij.
- Përveç ndryshimeve thelbësore që kërkuan procedura të reja prokurimi, është bërë edhe shtim/zvogëlim i sasive të pozicioneve brenda kontratës së parë. Edhe pse këto lëvizje nuk e kanë tejkaluar kufirin ligjor prej 10% të vlerës së kontratës, ato pasqyrojnë qartë se projektimi dhe planifikimi fillestar nuk ishin të bazuar në analiza të mjaftueshme teknike.
- Gjatë zbatimit të projektit, ShSKUK ka ndryshuar destinimin e disa dhomave që fillimisht ishin planifikuar për pacientë, duke i përdorur për qëllime të tjera mbështetëse. Këto ndryshime nuk ishin të parashikuara në planin fillestar dhe kanë reduktuar kapacitetin e objektit për trajtimin e pacientëve. Për më tepër, për shkak të këtyre ndryshimeve të shumta, projekti nuk është finalizuar as brenda afatit të fundit të caktuar. Punimet kanë përfunduar në qershor të vitit 2024, në vend se të përfundojnë në janar të vitit 2021, duke e rritur kohëzgjatjen e zbatimit të projektit nga 1.5 vite sa ishte planifikuar në rreth pesë vite.

Menaxhimi jo i duhur i kontratës dhe kontrollit financiar ka ndikuar drejtpërdrejt në ecurinë dhe tejkalimin e buxhetit të projektit

Zbatimi i këtij projekti është karakterizuar me një menaxhim jo të mirë të kontratës dhe mungesë kontrolli të rregullt financiar, gjë që ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin joefikas dhe devijimin financiar.

- Pas ndryshimeve në kontratë, përmes shtimit dhe zvogëlimit të sasive të pozicioneve si dhe lidhjes së kontratës së dytë për punë të paparashikuara, çmimi total i kontratës për projektin arriti në shumën mbi 2,57 milion euro, që paraqet një rritje prej 360 mijë euro ose mbi 16%. Ky tejkalim, jep sinjal për jo-efikasitet.
- Për shkak të menaxhimit jo të duhur, janë evidentuar tejkalime të sasive në vlerë prej 75,459 euro pa miratim paraprak të menaxhmentit. Gjithashtu, kemi konfirmuar se janë kryer tri pagesa për kontratën përkatëse, në vlerë mbi 255 mijë euro, pa nënshkrimin dhe raportin e menaxherit të kontratës. Këto pagesa janë ekzekutuar gjatë periudhës kur menaxherja e kontratës ka qenë jashtë detyrës. Gjatë kësaj periudhe nuk është emëruar ndonjë menaxher zëvendësues, dhe si rezultat pranimi teknik dhe pagesat janë realizuar vetëm mbi bazën e raportit të pranimi nga komisioni i pranimi i themeluar enkas për të zëvendësuar menaxherin e kontratës.
- Për shkak të mungesës së menaxherit të kontratës, ShSKUK nuk ka bërë një vlerësim të dokumentuar të performancës së kontratës, as gjatë periudhës së implementimit dhe as pas përfundimit të saj. Kjo pamundëson një reflektim objektiv për ecurinë, sfidat dhe përvojat e nxjerra nga ky projekt, që do të shërbenin për përmirësim në projektet e ardhshme.

Për të siguruar se kontratat e ardhshme të ndërtimit në ShSKUK zbatohen në mënyrë efikase, ne kemi dhënë gjashtë rekomandime. Lista e plotë e rekomandimeve është paraqitur në kapitullin pesë të këtij raporti.

Përgjigja e entitetit

ShSKUK është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe është zotuar se do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Detyra dhe qëllimi i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (tutje ShSKUK) është të sigurojë ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve shëndetësore cilësore, të sigurta dhe të qasshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, avancimin e kërkimeve shkencore, edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve mjekësorë dhe promovimin e kujdesit shëndetësor për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme në vend.

ShSKUK është institucion publik i shërbimit shëndetësor, që kryen veprimtari shëndetësore, edukative dhe kërkimore në fushën e shëndetësisë në pajtim me legjislacionin përkatës.

Investimet kapitale në ShSKUK janë thelbësore për përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore dhe rritjen e cilësisë së kujdesit mjekësor. Këto investime mundësojnë modernizimin e pajisjeve mjekësore, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, si dhe avancimin e teknologjisë dhe sistemeve të informacionit shëndetësor.

Kjo siguron që klinikat dhe spitalet universitare të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime mjekësore të nivelit të lartë, duke përfshirë diagnostifikim të avancuar, trajtim të sëmundjeve komplekse dhe shërbime urgjente. Gjithashtu, investimet e tilla krijojnë mundësi për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e profesionistëve të shëndetësisë, duke përmirësuar përvojën e studentëve dhe stafit akademik. Në këtë mënyrë, investimet kapitale janë një faktor kyç në avancimin e sistemit shëndetësor dhe rritjen e besueshmërisë së pacientëve ndaj shërbimeve që ofrohen.

Pjesë e këtyre investimeve kapitale, ishte edhe Ndërtimi i Klinikës së Ortopedisë i cili si proces ka filluar nga viti 2018. Ndërtimi i kësaj klinike ka qenë një projekt ambicioz dhe i domosdoshëm për forcimin e kapaciteteve të sistemit shëndetësor, sidomos në fushën e ortopedisë. Ky proces ka përfshirë disa faza të rëndësishme, nga planifikimi dhe projektimi e deri në përfundimin e ndërtimit dhe fillimin e ofrimit të shërbimeve mjekësore. Pjesë kyçe e këtij procesi është krijimi i kushteve moderne dhe të përshtatshme për trajtimin e pacientëve.

Klinika e Ortopedisë ka qenë e ndarë në dy objekte të cilat janë të lidhura me një korridor. Njëra pjesë e kësaj klinike (klinika e Ortopedisë me Traumatologji) është siç ka qenë, kurse një pjesë e objektit (blloku operativ) është planifikuar të rinovohet në pjesën e brendshme dhe pas kësaj të bëhet një mbindërtim me një kat më lartë. Shtesë e këtij objekti është planifikuar të jetë edhe një aneks ku janë sallat operative.

Klinika kishte edhe një repart me disa dhoma në katin e parë të një objekti të përbashkët me klinikat tjera që ndodhet rreth 200 metra distancë nga objekti që është ndërtuar tani. Në vitin 2019 klinika, në të gjitha objektet që kishte në dispozicion, kishte gjithsej 97 shtretër për pacientë dhe 3 sala operative.

2 Objektivi dhe pyetjet e auditimit

Objektiv i këtij auditimi është vlerësimi nëse ShSKUK ishte efikase në menaxhimin e projektit për ndërtimin e klinikës së Ortopedisë.

Me theks auditimi ka vlerësuar identifikimin e nevojave, zhvillimin e procedurave të prokurimit, menaxhimin e kontratave dhe monitorimin e duhur të performancës së kontratës për t'u siguruar që projekti është përfunduar në kohë, me çmimin e kontraktuar dhe sipas specifikacioneve teknike.

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit, ne kemi formuluar pyetjet dhe nën pyetjet si më poshtë:

1. **A janë zhvilluar procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat ligjore?**
2. **A është siguruar efikasitet gjatë menaxhimit dhe monitorimit të projektit sipas kushteve të kontraktuara?**

Fushëveprimi i këtij auditimi është i tërë procesi i ndërtimit të klinikës së Ortopedisë, nga fillimi në vitin 2018 dhe deri në finalizimin e projektit në vitin 2024. Ky auditim është fokusuar në planin projektues, menaxhimin kohor në përgjithësi, specifikacionet teknike dhe arsyet e vonesave gjatë kryerjes së punëve.


Palët përgjegjëse për realizimin dhe mbikëqyrjen e këtij projekti përfshijnë Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), si dhe Klinikën e Ortopedisë.

Metodologjia e detajuar e auditimit e aplikuar gjatë këtij auditimi, kriteret e auditimit, fushëveprimi i auditimit, përshkrimi detaj i sistemit dhe përgjegjësitë e palëve relevante janë të paraqitura në shtojcën 1 të këtij raporti.

3 Gjetjet e auditimit

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, përkatësisht Qendra Klinike Universitare e Kosovës si pjesë e ShSKUK-së, ka qenë autoriteti kontraktues që ka lidhur kontratën “Mbindërtimi dhe zgjerimi i objektit ekzistues të klinikës së Ortopedisë”. Kontrata përmban fjalën “mbindërtimi” sepse klinika tashmë kishte një objekt njëkatësh në atë lokacion, mbi të cilin QKUK-ja planifikonte ta ndërtonte edhe një kat. Nevoja për mbindërtim (shtimin e një kati më lartë mbi objektin ekzistues), renovim të objektit ekzistues, dhe ndërtimin e një aneksi objekti ngjit me të kanë rrjedhur për shkak të kushteve jo të mira në të cilat gjendej objekti që kishte në dispozicion kjo klinikë.

Figura 1 Skica e objektit si duket aktualisht



Procedurat për realizimin e këtij projekti kanë filluar në vitin 2018, me inicimin e fazës së projektimit dhe hartimin e planit ndërtimor. Pas përfundimit të projektit ideor dhe përgatitjes së dokumentacionit teknik, është vazhduar me zbatimin e punimeve ndërtimore dhe finalizimin e projektit. Për realizimin e plotë të këtij projekti, janë lidhur gjithsej katër kontrata: një kontratë për projektimin e planit ndërtimor, dy kontrata për kryerjen e punimeve ndërtimore dhe një kontratë për mbikëqyrjen e zbatimit të punëve. Vlera totale e angazhimeve kontraktuale për të gjitha komponentët e projektit kap shifrën prej afër 2.6 milionë euro.

Klinika është përruruar në tetor të vitit 2024 ku dhe ka filluar ofrimin e shërbimeve për pacientë.

3.1 Mangësitë e planifikimit fillestar dhe procedurat e prokurimit jo në përputhje me kërkesat ligjore kanë ndikuar në performancën e projektit

Efikasiteti i ShSKUK-së në ndërtimin e projektit është cenuar për shkak të disa mangësive, përfshirë planifikimin jo të mirëfilltë dhe mungesën e qartësisë në vlerësimin e nevojave, gjë që ka çuar në devijime të konsiderueshme gjatë zbatimit. Janë përzgjedhur operatorë ekonomik fitues pa përmbushur kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit, ndërsa humbja e dokumentacionit të ofertuesve ka cenuar integritetin e procesit të prokurimit. Si pasojë e planifikimit të dobët, janë bërë disa ndryshime në specifikime dhe është lidhur kontratë e re, duke ndikuar në efikasitetin e projektit. Planifikimi jo i duhur ka rezultuar edhe në ndërrimin e destinimit të disa hapësirave të parapara për pacientë, duke i shfrytëzuar ato për qëllime të tjera.

3.1.1 Planifikim jo i duhur i projektit dhe paqartësi në vlerësimin e nevojave

Para fillimit të një projekti, QKUK gjatë vlerësimit të nevojave dhe përgatitjes së një plani ideor duhet të bëjë mbledhjen dhe analizën e të dhënave, përdorimin e teknikave të avancuara analitike si dhe përfshirjen e të gjithë grupeve të interesit të nevojshëm për të garantuar një pasqyrë të plotë të nevojave i përshtatshëm për atë investim. Para shpalljes së procedurave të prokurimit, QKUK duhet të bëjë një analizë dhe vlerësim në vend, të situatës aktuale të objektit ku mendohet të bëhet renovimi dhe çdo ndërtim tjetër.

Plani për renovimin dhe ndërtimin e klinikës së Ortopedisë ka qenë i paraparë të zhvillohet në tri etapa: renovimi i brendshëm i objektit ekzistues, mbindërtimi i një kati si dhe integrimin e objektit të ri me atë ekzistues.

Sipas kërkesës iniciuese dhe dosjes së tenderit ‘për projektimin e projektit kryesor’, nevojat për ndërtim kanë qenë urgjente dhe janë vendosur kushtet kryesore të punëve që janë menduar të nevojshme për funksionalizimin e objektit. Megjithatë, kërkesa iniciuese dhe fillimi i procedurave është bërë pa vlerësuar saktë gjendjen aktuale të objektit ekzistues të klinikës. Fillimisht është planifikuar që objekti ekzistues të ketë vetëm renovim, mirëpo gjatë fazës së analizave në teren, para se të hartohet projekti kryesor, inxhinierët e QKUK-së kishin vlerësuar se është më e përshtatshme të demolohej objekti ekzistues dhe të ndërtohet nga themelet përsëri. Ky objekt ishte ndërtuar në vitin 2005.

3.1.2 Pamjaftueshmëria në dokumentimin e procedurave të prokurimit

Për zhvillimin e procedurave të prokurimit, qoftë për shërbim apo investim, QKUK duhet të caktoj paraprakisht disa kriteret për OE-të konkurruese në mënyrë që të plotësoj kërkesat e nevojshme për atë projekt. Bazuar në këto kriteret, komisioni i vlerësimit bënë analizimin dhe përzgjedhjen e OE-së përgjegjëse për projektin në fjalë. Gjithashtu, të gjitha dosjet e tenderit si pjesëmarrës për atë procedurë, është e detyrueshme që të ruhen në arkivë si dhe në formë elektronike, kjo për shkak të transparencës.

Mos plotësimi i kriterëve të përzgjedhjes të përcaktuara nga vetë QKUK

Gjatë shqyrtimit të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga QKUK për këtë projekt, janë evidentuar mospërputhje në përmbushjen e kriterëve të kapacitetit teknik dhe profesional nga operatorët ekonomik. Këto mospërputhje lidhen kryesisht me mungesën e dokumentacionit dëshmues, si kontratat dhe referencat për stafin teknik të kërkuar, edhe pse këta operatorë janë shpallur fitues të kontratave përkatëse.

Caktimi i këtyre kriterëve specifike për vlerësimin e operatorëve ekonomik ishte bërë me idenë që përzgjedhja të jetë sa më konkrete dhe përkatëse lidhur me natyrën e projektit. Sipas zyrtarëve, për shkak të urgjencës së nevojave për këtë klinikë, QKUK i ka tejkaluar këto kriterë dhe ka shpallur OE-të fituese edhe pa i plotësuar kriteret e vetë kërkuara.

Tenderi për Hartimin e projektit kryesor

Tenderi (konkursi i projektimit) kishte për qëllim përzgjedhjen e një kompanie për hartimin e projektit kryesor për klinikën e ortopedisë. Ky projekt do të duhej të siguronte një zgjidhje teknike cilësore, në përputhje me standardet për objektet spitalore, sipas zyrtarëve të QKUK-së.

Sipas dosjes së tenderit, kompania duhej të kishte përvojë në projektimin e të paktën një objekti shëndetësor, ndërsa Menaxheri i kontratës duhej të kishte hartuar të paktën dy projekte spitalore. Kompania përfituese nuk ka ofruar dëshmi për përvojën e kërkuar në projektimin e objekteve shëndetësore. Po ashtu, Menaxheri i kontratës nuk ka dokumentuar përvojën në dy projekte spitalore, siç kërkohej.

QKUK-ja si autoritet kontraktues kishte pranuar dokumentacion referues, por jo dëshmi konkrete (si kontrata apo projekte të përfunduara) që dëshmojnë përmbushjen e kriterëve. Pavarësisht kësaj, QKUK-ja e kishte shpërblyer me kontratë kompaninë projektuese.

Kjo ka ndodhur për shkak se komisioni i vlerësimit nuk e ka bërë si duhet vlerësimin dhe verifikimin e plotë të përvojës teknike.

Përzgjedhja e një kompanie, personave kyç të së cilës i mungon përvoja adekuate në projektim, ka ndikuar që projekti të mos hartohet si duhet e për pasojë ka çuar në pranimin e një projekti që nuk i plotësonte si duhet nevojat e klinikës.

Mungesa e përvojës së dëshmuar në projektimin e objekteve shëndetësore është bërë shkak për hartim joadekuat të projektit, i cili ka ndikuar në funksionalitetin dhe koston e përgjithshme të ndërtimit të objektit spitalor.

Tenderi për Mbindërtim dhe zgjerim të klinikës së ortopedisë

Tenderi kishte për qëllim përzgjedhjen e një kompanie të kualifikuar për ndërtimin e klinikës së ortopedisë sipas projektit kryesor që QKUK-ja sapo e kishte pranuar. QKUK-ja synonte përmes këtij projekti zgjerimin e kapaciteteve infrastrukturore të klinikës së ortopedisë për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarë.

Sipas dosjes së tenderit, menaxheri i projektit duhej të kishte përvojë në të paktën tri projekte me kontrata dhe referenca; menaxheri i punishtes më së paku dy projekte; inxhinierët me tri referenca dhe kontrata në ndërtim të lartë, dhe një inxhinier duhej të ishte i specializuar në drejtimin konstruktiv.

Për menaxherin e projektit mungojnë kontratat që dëshmojnë përvojën. Për katër nga pesë inxhinierët, mungojnë kontratat për ndërtim të lartë. Për inxhinierin e drejtimit konstruktiv nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion. Me gjitha këto mangësi në ofertë QKUK-ja e kishte pranuar atë OE si të përgjegjshëm dhe e kishte shpërblyer me kontratë.

Procesi i vlerësimit të ofertave, nuk është zhvilluar si duhet. Përkundër ofertës me dokumente të mangëta dhe të pa mbështetura me dëshmi të plota, QKUK e ka konsideruar atë të përgjegjshme duke mos kërkuar kontrata të cilat do të dokumentonin realisht përvojën dhe kompetencat e stafit kyç, sepse kishin vlerësuar se mjafton që janë ofruar referencat si dëshmi që ky kriter i përzgjedhjes është plotësuar.

Mospërfillja e kriterëve të përzgjedhjes përveç që paraqet trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomik, paraqet edhe rrezik për zbatim të dobët të kontratës.

Angazhimi i stafit teknik pa përvojë të dëshmuar ka shkaktuar menaxhim joadekuat të projektit ndërtimor, dhe ka ndikuar negativisht në cilësinë e punimeve, vonesa në realizim – duke ndikuar kështu në efikasitetin ndërtimit të klinikës.

Tenderi për Mbikëqyrjen e zbatimit të projektit ndërtimor

Mbikëqyrja profesionale e punimeve ndërtimore është thelbësore për të siguruar cilësi, përputhshmërinë me projektin dhe përdorimin e sigurt të objekteve shëndetësore. Sipas kërkesave të tenderit, pesë inxhinierë duhej të kishin përvojë në mbikëqyrjen e të paktën pesë projekteve në ndërtim të lartë, të dëshmuara përmes kontratave të punës.

Për pesë inxhinierët janë dorëzuar vetëm referenca, ndërkohë që mungojnë kontratat që do të dëshmonin realisht përvojën në mbikëqyrjen e projekteve ndërtimore.

Komisioni i vlerësimit të ofertave i QKUK-së nuk ka kërkuar apo verifikuar dokumentacion të plotë për të vërtetuar përvojën, duke pranuar vetëm këto referenca si dëshmi.

Mungesa e mbikëqyrjes profesionale të kualifikuar mund të çojë në zbatim të dobët të punimeve, rritje të defekteve teknike dhe rrezikim të qëndrueshmërisë së objektit. Kjo ndikon direkt në cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve që objekti do të ofrojë.

Mungesë e dosjeve të operatorëve tjerë pjesëmarrës

Në procedurën 'Hartimi i projektit kryesor për klinikën e Ortopedisë' kanë marrë pjesë tre ofertues, ndër ta OE fitues me ofertë 19,299 euro dhe një OE me ofertë më të lirë në vlerë prej 13,806 euro. OE i diskualifikuar si i papërgjegjshëm ka qenë më i lirë se kompania fituese për 5,493 euro apo për 29%. Sipas raportit të vlerësimit, kjo kompani është shpallur e papërgjegjshme për arsye se nuk kishte sjellë dy dosje origjinale si dhe nuk kishte plotësuar disa kriterë tjerë.

Ne kemi kërkuar vlerësimin e dosjes ofertuese nga kjo kompani, mirëpo këtë dosje zyrtarët nuk ishin në gjendje të gjejnë fizikisht. Ndërkaq, në formë elektronike nuk është për arsye se është procedurë e vitit 2018 dhe e-prokurimi nuk ka qenë funksional në atë kohë.

Gjendja jo e mirë e arkivës së QKUK-së dhe mos arkivimi i dosjeve sipas referencave, ka bërë që kjo dosje të mos gjendet.

Mungesa e dokumentimit adekuat dhe veprimi në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit, cenonjë transparencën e procesit të vlerësimit të ofertave. Mos dokumentimi i arsyetuar i shpalljes së ofertuesit më të lirë si të papërgjegjshëm ka ndikuar në përzgjedhjen e një operatori me çmim më të lartë, duke rritur rrezikun për përdorim joefikas të fondeve publike

3.1.3 Projektimi joadekuat ka ndikuar në ndryshime të mëdha gjatë zbatimit të kontratës së ndërtimit

Projekti ideor dhe ai përfundimtar duhet të jenë të hartuar në mënyrë të detajuar, të bazuar në nevojat reale dhe analizë të saktë të kushteve në terren, në mënyrë që të minimizohen ndryshimet gjatë fazës së zbatimit dhe të sigurohet realizim efikas dhe ekonomik i kontratës.

Kontrata e lidhur në vitin 2019 për kryerjen e punimeve për klinikën e Ortopedisë ka qenë e planifikuar të përfundoj pas 570 ditëve apo më saktësisht në muajin janar 2021. Mirëpo, gjatë punimeve kompania punë kryese ka identifikuar mangësi në projektim, duke vlerësuar se disa pozicione nuk ishin të përshtatshme për disa pjesë të klinikës. Sipas raportit të kësaj kompanie, pjesa e ventilimit të sallës së operimeve, muret e veshura me bakër, izolimi i sallave të reja operative me mbrojtje X-ray (mbrojtje nga rrezatimi), profili i dyerve në sallën e operimeve, makineritë dhe pjesët përcjellëse të tyre nuk ishin të përshtatshme.

Si rezultat, është dashur të bëhet një rivlerësim komplet i pozicioneve të kontratës nga kompania e kontraktuar në rolin e Organit Mbikëqyrës dhe nga menaxheri i kontratës. Pas analizave dhe vlerësimit të gjendjes në teren, të dy palët ishin pajtuar se ndryshimet janë të domosdoshme dhe rekomandimi i tyre ka qenë shpallja e një procedure të re të prokurimit. ShSKUK kishte publikuar tenderin e hapur, me ç' rast është lidhur kontratë e re për punë të paparashikuara me të njëjtën kompani punë kryese. Për këto ndryshime është marrë aprovimi nga menaxhmenti i QKUK-së dhe kanë vazhduar procedurat e prokurimit me kohëzgjatje të shkurtuar.

Edhe pse ndryshimet janë aprovuar, vlerësimi i tyre dhe procedurat e reja të prokurimit kanë ndikuar në shtyrjen e afatit kohor për përfundimin e projektit.

Përveç ndryshimeve për të cilat kanë qenë të pashmangshme procedurat e reja të prokurimit, janë bërë edhe shtim/largim i sasive të pozicioneve brenda kontratës së parë. Në raportin final të pranimi (Situacioni i 11), kemi vërejtur që ka pasur lëvizje të sasive pozicioneve pothuajse në të gjitha fushat e ndara sipas fazave të ndërtimit. Edhe pse këto lëvizje nuk e tejkalojnë 10% e vlerës së kontratës e cila është e lejuar me ligjin e prokurimit, megjithatë kjo jep një informatë që planifikimi dhe projektimi nuk kanë qenë mjaftueshëm mirë të analizuar.

Tabela 1 Analiza e ndryshimeve në sasi gjatë realizimit të projektit:

Kategoria	Largimi i sasive (€)	Shtimi i sasive (€)
Arkitektura	187,823	131,350
Hidro-instalimet	4,974	1,947
Rrymat e forta	65,659	10,277
Rrymat e dobëta	2,770	1,670
Ngrohja / Ftohja	9,444	9,074
Ventilimi	105,710	3,562
Nën-stacioni	27,100	9,788
Stacioni i gazrave medicinale	33,965	23,600
Uji i ngrohtë sanitar	3,789	1,164
TOTAL	441,234	192,432

Nga tabela më lartë vërehet se gjatë realizimit të projektit janë bërë ndryshime të konsiderueshme në sasi të e pozicioneve të ndryshme brenda secilës kategori, krahasuar me kontratën fillestare. Në disa pozicione sasi të janë zvogëluar, në vlerë prej 441,234 € dhe disa pozicione sasi të janë shtuar në vlerë prej 192,432€, duke rezultuar në një ulje neto prej 248,802 € nga vlera fillestare e kontratës.

Përveç ndryshimeve të theksuara më lartë, me kërkesë nga stafi mjekësor i klinikës së Ortopedisë, janë shtuar edhe pozicione të reja sepse, sipas tyre, pa to funksionalizimi i klinikës do të ishte jo i plotë. Disa nga ndryshimet janë prezantuar në grafikun si më poshtë:



Gjatë inspektimit fizik të objektit, kemi konstatuar se një hapësirë e dedikuar për vendosjen e pajisjeve elektrike (orman elektrik dhe UPS) nuk ishte ndërtuar në harmoni me përmasat e pajisjeve dhe nuk i plotësonte kushtet teknike për vendosjen dhe funksionimin e tyre. Si rrjedhojë, kësaj dhome i'u është ndërruar destinimi dhe tani përdoret për qëllime tjera, ndërsa një dhomë e planifikuar për pacientë tani shfrytëzohet për vendosjen dhe funksionimin e këtyre pajisjeve.



Figura 2- dhomë e planifikuar për pacientë e cila shfrytëzohet si dhomë e elektrikës

Ndërtesa e re e klinikës së ortopedisë ishte paraparë të ketë 4 salla të operimeve, 26 dhoma për akomodim të 52 pacientëve, si dhe dhoma tjera për qëllime të ndryshme (dhoma të mjekëve, dhoma të infermierëve, zyra, triazhi, dhoma e oksigjenit, kuzhina etj).

Gjatë ekzaminimit kemi vërejtur se dy dhoma të destinuara për pacientë ishin duke u përdorur si dhoma për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, dhe jo për qëllimin fillestar të tyre.



Figura 3- dhomë e planifikuar për pacientë e cila shfrytëzohet si dhomë e ndihmës së parë

Gjithashtu, një pjesë e objektit e planifikuar për vendosjen e makinerive, e cila ndodhet si pjesë shtesë mbi katin e dytë të ndërtesës, nuk është shfrytëzuar për qëllimin e paraparë. Makineritë janë instaluar në një pjesë tjetër të objektit në ambient të hapur, për shkak të nevojës urgjente për t'i vënë në funksion sepse vendi ku parashiheshin të vendoseshin ende nuk ishte ndërtuar. Aktualisht, objekti i destinuar për vendosjen e këtyre pajisjeve është duke u shfrytëzuar për zhvillimin e takimeve të kolegjiave apo të stafit të klinikës.



Figura 4- makineritë për funksionimin e klinikës të cilat janë vendosur në anën tjetër të objektit




Figura 5- objekti i ndërtuar mbi kulm, i cili është planifikuar të vendosen makineritë e prezantuara më lartë

Devijimet e cekura më lartë çojnë në përfundim se projekti kryesor për ndërtimin e objektit të klinikës nuk është mbështetur në një analizë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të nevojave reale të institucionit shëndetësor.

Si rezultat, projekti kryesor ka qenë i paplotë dhe jo i harmonizuar me kushtet reale në terren, gjë që ka sjellë nevojën për ndryshime të konsiderueshme të tij gjatë zbatimit të punimeve. Këto mangësi kanë çuar në ndryshime në sasi dhe përmbajtjen e kontratës fillestare duke shkaktuar jo vetëm vonesa në ndërtim të objektit, por edhe kosto shtesë.

Përfundimisht QKUK-ja nuk ishte efikase në ndërtimin e klinikës së ortopedisë sepse ndërtimi i saj kishte marrë kohë konsiderueshëm më të gjatë si dhe më shumë fonde se që ishte planifikuar fillimisht.

Kjo kishte ndodhur për shkak se QKUK kishte kontraktuar kompani për hartim të projektit, pa përvojë të mjaftueshme dhe të dëshmuar në hartimin e projekteve shëndetësore.

Për pasojë është hartuar projekt kryesor jo adekuat që është reflektuar më vonë me ndryshime të konsiderueshme në para-masë/kontratë, si dhe është lidhur edhe një aneks kontratë me kosto shtesë për QKUK-në.

3.2 Jo efikasitet në menaxhimin dhe monitorimin e projektit

Zbatimi i projektit është karakterizuar nga një sërë devijimesh që tregojnë për mungesë të efikasitetit në menaxhimin dhe monitorimin e tij. Projekti nuk është realizuar në përputhje me planin dinamik të punimeve, duke rezultuar në vonesa të konsiderueshme në afatet e parashikuara të përfundimit. Krahas kësaj, është evidentuar tejkalim i çmimit të kontratës, si dhe ekzekutim i situacioneve shtesë të punimeve pa aprovim paraprak, në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe procedurat e prokurimit publik.

Më tej, është konstatuar se janë kryer pagesa për punimet e realizuara edhe në mungesë të emërimit dhe angazhimit të një menaxheri të kontratës, gjë që ka ndikuar në mungesën e mbikëqyrjes efektive dhe të dokumentuar të procesit të zbatimit të kontratës.

3.2.1 Ekzekutimi i punëve nuk ishte kryer sipas afateve të përcaktuara në planin dinamik

Zbatimi i projektit duhet të realizohet në përputhje me planin dinamik të kontraktuar nga QKUK, duke siguruar përfundimin e punëve brenda afateve të përcaktuara dhe pa vonesa, me qëllim përdorimin efikas të burimeve dhe arritjen e objektivave të projektit në kohën e parashikuar.

Dy procedurat e prokurimit “Mbindërtimi dhe zgjerimi i objektit ekzistues të klinikës së Ortopedisë” dhe “Punët e paparashikuara për klinikën e Ortopedisë” janë zhvilluar me afate të shkurtuara kohore, me arsyetimin se nevojat për klinikën e re dhe përmirësimi i kushteve për trajtimin e pacientëve paraqesin nevojë urgjente. Megjithatë, QKUK nuk ka arritur të jetë efikase në përmbushjen e këtij objekti. Më poshtë gjeni një përshkrim të shkurtër të ecurisë së dy kontratave:

1. Kontrata e parë – “Mbindërtimi dhe zgjerimi i objektit ekzistues të klinikës së Ortopedisë” është lidhur në vitin 2019. Sipas planit dinamik të miratuar, punimet është dashur të përfundonin në fillim të vitit 2021. Megjithatë, që nga fillimi i realizimit të kontratës janë shfaqur sfida të cilat kanë ndikuar në rrjedhën normale të realizimit të punimeve. Kronologjia e këtyre sfidave dhe problemeve është prezantuar si më poshtë:
 - Zhvillimi i procedurave të prokurimit kishte filluar në muajin mars 2019, përderisa kërkesa për lejen e ndërtimit në Komunën e Prishtinës ishte bërë në muajin maj 2019. Obligimet kontraktuale kishin filluar në muajin korrik 2019, kurse leja për ndërtim është lëshuar në gusht 2019. Për pasojë OE nuk i ka filluar punimet derisa është marrë leja;
 - Moti i ligë ka qenë një faktor tjetër që ka ndikuar në shtyrjen e punimeve për tre muaj (dhjetor 2019 dhe janar-shkurt 2020);
 - Periudha e pandemisë Covid-19 ka bërë që për dy muaj tjerë të ndalen punimet; si dhe
 - Mungesa e një planifikimi të mirëfilltë nga kompania projektuese, e cila kishte hartuar projektin fillestar, solli nevojën për rishikim të projektit dhe ndaljen e punimeve për gjashtë muaj tjerë (mars- gusht 2021) për të zhvilluar një procedurë të re prokurimi.
2. Kontrata e dytë – “Punët e paparashikuara për klinikën e Ortopedisë” është lidhur në gusht 2021, me afat zbatimi 365 ditë kalendarike, përkatësisht deri në gusht 2022. Edhe pse kontrata kishte një periudhë të qartë zbatimi, për shkak të shtimit të volumit të punëve dhe mos menaxhim i kontratës në kohë reale, punimet nuk u përfunduan brenda këtij afati.

3. Aneks kontratë- është lidhur në mes QKUK-së dhe kompanisë ndërtuese për shtyrje të afatit të punimeve deri në gusht të vitit 2023. Ky proces nuk ishte i shoqëruar nga një kërkesë me arsyetim të qartë dhe dokumentacion përkatës.

Ky proces kishte vazhduar me dy vendime shtesë për zgjatjen e vlefshmërisë së kontratës:

- Vendimi i parë: nga 24 gusht 2023 deri më 24 dhjetor 2023, dhe
- Vendimi i dytë: nga 24 dhjetor 2023 deri më 22 mars 2024.

Megjithëse u lejuan këto shtyrje të afateve, projekti nuk është finalizuar as brenda afatit të fundit të përcaktuar, duke rezultuar në vonesë të theksuar në përfundimin e punimeve dhe dorëzimin e objektit për përdorim.

Pranimi i situacioneve përfundimtare nga kompania e angazhuar si Organ Mbikëqyrës është bërë në qershor të vitit 2024, ku krahasuar me datën e fundit të lejuar me vendim është një hapësirë kohore për 3 muaj, ndërsa krahasuar me datën fillestare të planifikuar për përfundimin e punimeve distanca kohore është më shumë se tri vite vonesë.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i planifikimit jo të duhur të projektit që nga faza ideore deri te projekti final.

Edhe pse janë përdorur procedura të prokurimit me afate të shkurtuara, me arsyetimin e urgjencës, QKUK-ja nuk ka arritur që ta ndërtojë objektin e klinikës brenda afateve të arsyeshme. Kjo sepse QKUK, ndër tjera, kishte kontraktuar kompani të papërgjegjshme për hartim të projektit kryesor. Si rezultat, projekti kryesor ishte i mangët dhe ka kërkuar modifikime, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejt në vonesa të konsiderueshme në zbatimin e tij dhe në mos arritjen e objektivave të përcaktuara, për aq kohë sa është vonuar ndërtimi i klinikës.

3.2.2 Tejkallim i çmimit të kontratës, situacioneve pa aprovim dhe ekzekutim i pagesave pa raport të menaxherit të kontratës

Projektet duhet të realizohen brenda buxhetit të ndarë dhe në përputhje me vlerën/çmimin e përcaktuar në kontratë. Çdo ndryshim në kosto duhet të jetë i justifikuar me dokumentacion të plotë dhe i menaxhuar në mënyrë efektive për të garantuar përdorim të arsyeshëm të fondeve publike. Po ashtu, procesi i ekzekutimit të pagesave duhet të bazohet në raportet për punët e kryera dhe të jetë i miratuar nga menaxheri i kontratës. Pagesat e realizuara pa këtë aprovim cenojnë kontrollin e brendshëm dhe rrisin rrezikun për pagesa të pajustificuara ose jo në përputhje me kontratën.

Më poshtë po paraqesim aspektin financiar të projektit, përkatësisht vlerën e secilës kontratë dhe pagesat përkatëse.

- Çmimi i kontratës për kryerjen e punimeve bazuar në projektin kryesor fillestar ishte afër 2,21 milion euro. Mirëpo, pas ndryshimeve të disa pozicioneve (largimi/shtimi i tyre) brenda kësaj kontrate, ndryshoi edhe çmimi total kontratës. Si rezultat, vlera neto e kontratës ishte reduktuar në 1,96 milion euro.
- Lidhja e kontratës së dytë, për punë të paparashikuara, ka rezultuar me rritje të koston së projektit për afër 0,6 milion euro. Nga kjo, shuma e kontratës së parë dhe asaj të dytë kap vlerën mbi 2,55 milion euro.

- Pagesat totale për kompaninë punë kryese nga viti 2019-2025 kanë arritur vlerën në 2,57 milion euro, duke e tejkaluar çmimin e kontraktuar për 16,836 euro. Pra kosto totale e projektit nga 2.21 milion sa është menduar se do të jetë, është rritur në 2.57 milion që përbën një rritje në kosto mbi 16% krahasuar me kontratën fillestare.




Figura 6- Rrjedha e ndryshimit të vlerës së kontratave dhe pagesat totale

Në situacionin nr.11 (të kontratës së parë) janë evidentuar tejkalime të sasive në vlerë 70,894 euro, ndërsa në situacionin nr. 6 (të kontratës së dytë për punë të paparashikuara) tejkalimet kapin vlerën 4,565 euro. Po ashtu, në një pozicion 'montimi i dritareve PVC', është konstatuar se janë furnizuar tri (3) dritare më pak se sasia e paraparë në kontratë, ndërkohë që çmimi i faturuar rezulton të jetë më i lartë. Ky devijim ka ardhur si pasojë e ndryshimit të profilit të dritareve gjatë fazës së zbatimit, për shkak të një gabimi në projektim.

Të gjitha këto tejkalime, janë bërë pa miratim paraprak të menaxhmentit, çka ka rezultuar në rritje të koston për njësi dhe, rrjedhimisht, në tejkalim të vlerës së kontratës.

Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i projektimit jo të saktë dhe të papërshtatshëm në fazën fillestare të hartimit të projektit, ku nuk janë identifikuar në kohë të gjitha kërkesat teknike të përshtatshme për objektin, duke përfshirë këtu edhe dritaret me profil standard, të cilat nuk ishin të përshtatshme për natyrën dhe specifikat funksionale të objektit. Ndërkaq, për tejkalimet e sasive pa aprovim, nuk ka ndonjë arsye konkrete, përveç një raporti nga Komisioni për Pranimin e Dokumentacionit, i formuar ad hoc, ku specifikohet qartë se ka pasur tejkalime të cilat janë aprovuar nga Organi Mbikëqyrës por jo nga menaxhmenti i ShSKUK-së.

Gjithashtu, për këtë kontratë janë ekzekutuar tri pagesa në vlerë mbi 255 mijë euro, pa nënshkrimin dhe raportin e menaxherit të kontratës, siç kërkohet nga rregullat dhe procedurat për menaxhimin e kontratave.

Kjo ka ndodhur pasi menaxherja e kontratës kishte dhënë dorëheqje ende pa u zbatuar kontrata plotësisht, ndërsa QKUK-ja nuk kishte emëruar një menaxher zëvendësues pas saj.

Si pasojë, pranimi teknik dhe pagesa e punëve të kryera është bërë me pesë muaj vonesë. Këtë e kishte bërë komisioni i caktuar nga menaxhmenti i ShSKUK-së bazuar në interpretimin e lëshuar nga zyra ligjore.

Pagesa e tretë kishte ndodhur për shkak se, sipas zyrtarëve ligjorë të institucionit, është vlerësuar se është më e favorshme të kryhet pagesa edhe pa raportin e menaxherit të kontratës, sesa të vonohet procedura dhe të rrezikohet që lënda të kalojë në proces gjyqësor apo të përfundojë në përmbarim, me pasoja të mundshme financiare dhe ligjore për institucionin.

Në diskutim me zyrtarët përgjegjës, nuk kemi arritur të marrim përgjigje konkrete për këtë situatë. Sipas tyre, ka qenë sfiduese që në fund të projektit të ngarkohet ndonjë zyrtar tjetër si menaxher, kur pothuajse kontrata ka qenë në përfundim.

3.2.3 Mungesë e vlerësimit të performancës së kontratës nga autoriteti kontraktues

Në mënyrë që QKUK të siguroj përputhshmërinë me afatet, cilësinë e materialeve dhe kushte të tjera kontraktuale, kërkohet të bëjë vlerësimin e performancës së kontratës përkatëse. Ky proces duhet të dokumentohet në mënyrë të qartë dhe të miratohet nga menaxheri i kontratës dhe komisioni përkatës, duke përfshirë masa korrigjuese ose propozime për përmirësime në rastet kur ka devijime nga kushtet e kontratës.

Gjatë vlerësimit të kontratave për realizimin e projektit të klinikës së Ortopedisë, kemi konstatuar se autoriteti kontraktues nuk ka realizuar një vlerësim të dokumentuar të performancës së kontratës, as gjatë periudhës së zbatimit dhe as pas përfundimit të saj, siç kërkohet nga rregullat dhe praktikrat e menaxhimit të kontratave.

Mungesa e vlerësimit të performancës së kontratës mund të ndikoj që autoriteti kontraktues të mos ketë evidencë të qartë nëse kontrata po zbatohet sipas kushteve të dakorduara, duke rritur rrezikun që devijimet nga specifikimet teknike, cilësia e dobët e punimeve apo vonesat në zbatim të mos identifikohen në kohë.

Sipas zyrtarëve përgjegjës nuk ka pasur ndonjë arsye specifike për mosrealizimin e vlerësimit, por thjesht nuk e kanë ndërmarrë këtë veprim, çka tregon për mungesë të qasjes sistematike dhe të vetëdijesimit lidhur me rëndësinë e këtij procesi në menaxhimin efektiv të kontratave.

4 Konkluzionet

ShSKUK nuk ishte efikase në menaxhimin e projektit për ndërtimin e klinikës së Ortopedisë për arsye se planifikimin dhe menaxhimin nuk e kishte bërë si duhet. Për pasojë realizimi dhe futja në funksion e tij kishe marrë kohë më tepër se sa që ishte planifikuar, si dhe shpenzimet e realizuara kishin tejkaluar ato të planifikuara. Me fjalë tjera, përveç që është shtyrë për tri vite përmirësimi i kushteve të klinikës për trajtim të pacienteve, janë rritur edhe shpenzimet e ndërtimit për 16% në krahasim me planin, pa llogaritur këtu edhe koston e objektit të rrënuar që nuk kishte shumë kohë që ishte ndërtuar enkas për këtë klinikë.

Procedurat e prokurimit nuk ishin zhvilluar plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore

Projekti është nisur pa dokumentacion të plotë dhe të qartë që do të tregonte saktësisht nevojën për këtë investim. Kërkesa për projektin është bërë kryesisht në mënyrë verbale gjatë takimeve me stafin e klinikës së Ortopedisë, dhe nuk kemi gjetur në ndonjë dokument zyrtar që e mbështet këtë kërkesë, përveç një kërkesë nga stafi i departamentit për investime kapitale të ShSKUK-së. Kjo do të thotë se QKUK nuk ka dokumentuar komunikimin mes njësisë kërkuese dhe njësive tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij projekti e për pasojë ndryshimet e mëtejme në projekt nuk mund t'i atribuohen asnjërës njësi.

Po ashtu, para fillimit të procedurave nuk është bërë një vlerësim i plotë i gjendjes së objektit ekzistues. Fillimisht ishte menduar të bëhej vetëm renovim, por më pas u pa se objekti kishte nevojë të demolohej. Kjo tregon se nuk ka pasur planifikim të mirë dhe të saktë në fillim, gjë që ka shkaktuar ndryshime gjatë zbatimit të projektit.

Kontrolle të pamjaftueshme në procedurat e prokurimit kanë rezultuar me shmangie nga kërkesat e LPP-së. Operatorëve ekonomik të kontraktuar për këtë projekt i'u është dhënë kontrata edhe pse nuk kanë plotësuar plotësisht kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional, për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm si kontrata dhe referenca për stafin teknik. Kjo situatë rrezikon cilësinë e zbatimit të kontratave dhe e ulë besueshmërinë e operatorëve ekonomik në procesin e prokurimit sepse nuk siguron trajtim të drejtë dhe të barabartë të tyre, e që rrezikon që në proceset e ardhshme të ketë më pak konkurrencë, më pak cilësi dhe çmime më të larta.

Sistemi jo-efektiv i arkivimit të dokumenteve zyrtare ka bërë që QKUK-ja të mos jetë në gjendje të sigurojë ruajtjen dhe renditjen e duhur të dokumentacionit si dhe ka kufizuar qasjen në të, e rrjedhimisht edhe transparencën, gjë që ka pamundësuar vlerësimin e ofertës së diskualifikuar gjatë procesit të vlerësimit për procedurën "Hartimi i projektit kryesor për klinikën e Ortopedisë". Sistemi jo-efektiv për arkivim të dokumentacionit rritë rrezikun për vendimmarrje të paarsyetuara/ të pabazuara dhe kufizon llogaridhënien e personave përgjegjës në prokurim dhe në QKUK në përgjithësi.

Nuk ishte siguruar efikasitet gjatë menaxhimit dhe monitorimit të projektit sipas kushteve të kontraktuara

Ndryshimet që janë bërë gjatë zbatimit të projektit, si nënshkrimi i kontratës shtesë dhe rregullimet brenda kontratës fillestare, e mbështesin konkluzionin tonë se projektimi dhe planifikimi nuk kanë qenë të mjaftueshëm dhe të mirë analizuar qysh në fillim. Këto mangësi kanë bërë që të nevojiten ndërhyrje gjatë punimeve, gjë që ka vonuar përfundimin e projektit dhe e ka bërë më të ndërlikuar zbatimin e tij. Edhe pse këto ndryshime janë miratuar nga menaxhmenti dhe janë bërë në përputhje me rregullat, ato tregojnë që ka pasur dobësi në menaxhimin e projektit që nga fillimi.

Tejkalimi i çmimit të kontratës, pagesë e pozicionit jashtë kontratës, si dhe mungesa e rolit aktiv të menaxherit gjatë fazës së pagesave, kanë ndikuar në zbatimin jo të plotë të kërkesave ligjore dhe procedurale.

Mungesa e vlerësimit të dokumentuar të performancës së kontratës, si gjatë zbatimit ashtu edhe pas përfundimit të saj, mund të ndikojë në menaxhimin jo të duhur të projektit dhe në vonesa të zbatimit të tij. Përveç që është në kundërshtim me rregulloret/ udhëzuesit/ praktikat e mira, mungesa e vlerësimit të performancës së kontratës e pamundëson marrjen e veprimeve parandaluese gjatë zbatimit të kontratave të ardhshme.

Të gjitha çështjet e përshkruara më lartë kanë ndikuar që projekti të mos zbatohet me kohë, sipas planit fillestar, pavarësisht shtyrjeve të afateve të lejuara me vendim. Përfundimi i punimeve dhe dorëzimi i objektit për përdorim u bë me një vonesë të theksuar, duke u finalizuar në vitin 2024, pesë vite pas fillimit të projektit, me tri vite vonesë krahasuar me planin fillestar të ndërtimit.

5 Rekomandimet

Në mënyrë që QKUK në të ardhmen të menaxhojë më mirë proceset e investimeve të kësaj natyre, duke siguruar efikasitet në realizimin e planeve dhe të ketë një rol aktiv në menaxhimin e kontratave, rekomandojmë që të sigurohet se:

- çdo projekti të ri investiv t'i paraprijë dokumentacioni përcjellës i qartë, i detajuar dhe i bazuar në analizë të plotë të gjendjes ekzistuese dhe nevojave reale të njësisë kërkuese, në mënyrë që të minimizohen ndryshimet gjatë punimeve dhe të shmangen vonesat apo punët e paparashikuara;
- caktimi i kriterëve dhe kërkesave teknike e profesionale për vlerësim të ofertuesve, të jetë në përputhje me qëllimin dhe kompleksitetin e projektit;
- ka mbikëqyrje efektive mbi procesin e vlerësimit të ofertave duke siguruar se vetëm ofertuesit që i plotësojnë kriteret paraprakisht të vendosura të shpërblehen me kontratë, në mënyrë që edhe kontrata të zbatohet në mënyrë cilësore;
- mekanizmat e kontrollit (menaxheri i kontratës) dhe raportimit janë duke u zbatuar rregullisht, pa ndërprerje, për të siguruar komunikim efektiv mes operatorit ekonomik dhe menaxhmentit të QKUK-së si parakusht për zbatimin e kontratës sipas kushteve të saj, si dhe për të dokumentuar në detaje ecurinë e zbatimit të projektit krahas vlerësimit të performancës së operatorit ekonomik që e ka zbatuar atë;
- ndërmerren hapa për rritjen e vetëdijes dhe kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës mbi rëndësinë e vlerësimit të performancës së kontratës si mjet për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit në realizimin e projekteve të ardhshme; dhe
- ka marrë masa dhe ngritë kapacitetet për menaxhimin e sistemit të arkivimit të dokumentacionit, duke vënë në funksion një praktikë të standardizuar të ruajtjes dhe referencimit të tyre, në mënyrë që autoriteteve përkatëse t'u garantohet qasja në çdo dokument të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre, si dhe të mundësohet llogaridhënia e zyrtarëve përgjegjës të QKUK-së.

Shtojca 1. Motivi i auditimit, kriteret, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Problemi i auditimit

Raporte të ndryshme që janë publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) por edhe shoqëria civile e që lidhen me zhvillimin e procedurave për investime kapitale në përgjithësi, paraqesin situata sfiduese, sa i përket menaxhimit të kontratave dhe përfundimit të projekteve përkatëse në kohën e planifikuar. Problemet kryesore të identifikuara në këto raporte janë vonesa në implementim, punët shtesë dhe të paparashikuara si dhe probleme tjera e që kryesisht janë në fushën e ndërtimit.

Në Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2023 është raportuar për realizim të ulët të projekteve kapitale si pasojë e vonesave në kryerjen e punëve dhe shërbimeve sipas planit dinamik të tyre. Po ashtu si rezultat i këtyre vonesave, ka raste të obligimeve të pa paguara që janë përcjellur në vitet vijuese duke i krijuar institucioneve obligime⁶.

Rreziqet eventuale që mund të ndërlidhen me menaxhimin e realizimit të këtyre projekteve, mund të jenë vonesat në përfundim të projekteve, pagesa përtej planifikimit e rrjedhimisht mos marrja e përfitimeve me kohë nga investimi në Klinikën e Ortopedisë.

Vonesa të njëjtës natyrë kishte edhe në realizimin e projektit për ndërtimin e Klinikës së Ortopedisë. Edhe pse ky projekt ka filluar që nga viti 2019, nuk ka arritur të përfundohet sipas kohës së caktuar me kontratë sepse gjatë procesit punët ndërtuese janë ndërprerë për arsye se projekti është vlerësuar jofunksional dhe është dashur të ri projektohet⁷.

Problem tjetër me të cilin është ballafaquar ky projekt, ishte edhe mos plotësimi i kushteve sanitare, ku si pasojë janë mbyllur sallat e operimit nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës. Disa nga problemet e konstatuara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, ishin⁸:

- Hapësirat e këtij blloku operativ nuk i plotësojnë kushtet teknike sanitare dhe higjienike për ushtrim të veprimtarisë si sallë operative;
- Korridori që lidhë bllokun operativ me dhomat është punuar nga materiali që nuk është higjienik;
- Disa nga pajisjet janë të vjetruara-dëmtuara;
- Ka mungesë të ujit të ngrohtë rrjedhës; dhe
- Në këtë njësi po ashtu ende nuk është përfunduar edhe nënstacioni i oksigjenimit qendror.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e një projekti si ky për të ju ofruar shërbime shëndetësore qytetarëve, auditimi i tij është shumë i rëndësishëm, me theks për faktin se ky projekt ka filluar në

⁶ Raporti Vjetor i Auditimit të Buxhetit 2023

⁷ <https://www.evropaelire.org/a/kushtet-ortopedi-milionat-qkuk-/32020690.html>

⁸ <https://ndertimi.info/qkuk-se-i-kushtoi-mbi-2-2-milione-euro-ndertimi-i-aneksit-te-klinikes-se-ortopedise-qe-nuk-i-ploteson-kushtet-sanitare/>

vitin 2018 por që nuk është finalizuar deri në tetor të vitit 2024. Pra, ishte e pamundur të vihej në përdorim për t'u ofruar qytetarëve shërbimet shëndetësore.

Auditimi ka vlerësuar nëse procedurat e zhvilluara janë në përputhje me kërkesat rregullative të përcaktuara, nëse projekti është realizuar sipas specifikave të përcaktuara dhe kontraktuara, nëse realizimi është bërë sipas planit kohor dhe nëse klinika mundëson ofrimin e shërbimeve për të cilat është ndërtuar.

Përshkrimi i sistemit dhe akterëve tjerë relevant

ShSKUK është themeluar përmes ligjit të Ministrisë së Shëndetësisë, si institucion shëndetësor, me rëndësi të veçantë publike. Ajo ka autonomi ligjore të personit juridik, me të drejta, detyrime, dhe përgjegjësi të veçanta për zbatim të këtij ligji dhe akteve nën-ligjore të nxjerra nga Ministria.

ShSKUK drejtohet nga Bordi Drejtues prej shtatë anëtarësh, me mandat tre vjeçar. Ky Bord udhëhiqet nga Kryesuesi i Bordit, me mandat një vjeçar. Me punët operative të ShSKUK-së udhëheq Drejtori i Përgjithshëm, të cilin e emëron Bordi Drejtues në bazë të konkursit publik. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për performancën profesionale dhe afarizmin financiar të ShSKUK-së. Fushëveprimi, autorizimet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm përcaktohen me Statutin e ShSKUK. Në kuadër të ShSKUK-së janë: Institucionet e nivelit dytësor (Spitali i Përgjithshëm dhe Special, me njësitë përbërëse) dhe Institucionet e nivelit terciar (Qendra Klinike Universitare, Qendra e Transfuzionit të Gjakut, etj.), të përcaktuara me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë. Projekti për ndërtimin e Klinikës së Ortopedisë është në kuadër të Institucioneve të nivelit terciar, e rrjedhimisht të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës – (tutje QKUK).

Fokus kryesor i këtij auditimi ishte vlerësimi se si është bërë identifikimi i nevojave për këtë projekt, si janë zhvilluar procedurat e kontraktimit, menaxhimi i kontratës dhe pranimi teknik i projektit. Më poshtë po e paraqesim diagramin e procesit sipas ligjit dhe rregulloreve në fuqi si dhe akterët përgjegjës për to.

Procesi i realizuar dhe akterët e përfshirë në këtë proces



Kriteret e auditimit

Qëllimi i auditimit është të vlerësojmë nëse ShSKUK është siguruar se planifikimi, zhvillimi i procedurave, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontratave janë bërë si duhet, ishin transparentë, ishin efikase dhe janë monitoruar si duhet.

Kriteret e auditimit në këtë auditim rrjedhin nga legjislacioni kombëtar mbi proceset e prokurimit rregulloret në fuqi.

- ShSKUK duhet të ndjekë të gjitha procedurat e përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik të Kosovës dhe çdo rregullore tjetër në fuqi, duke siguruar që secili hap në procesin e prokurimit është bërë në përputhje me dispozitat ligjore të këtij ligji;
- Duhet ndjekur procedurat e hapura dhe konkurruese për ofertat, si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për operatorët ekonomik;
- Kriteret të qarta dhe të drejta duhen të përdoren për vlerësimin e ofertave, duke përfshirë vlerësimin e çmimit, kualitetit dhe përvojës së ofertuesve;
- Afatet kohore të parashikuara për ndërtimin e klinikës duhet të jenë në pajtueshmëri me atë të realizuar dhe kontraktuar;
- Proceset e monitorimit të realizimit të punimeve, duke përfshirë raportet e periodike të progresit dhe mbajtjen e evidencave mbi avancimin e punimeve duhet të jenë në përputhje me planin e projektit;

-
- Nëse janë raportuar devijime të mundshme nga plani i projektit, siç janë vonesat në ndërtim, ndryshimet e çmimeve ose kërkesat për punë shtesë, menaxhmenti duhet të siguroj nëse këto devijime janë arsyetuar dhe menaxhuar siç kërkohet nga kontrata;
 - Plan i ideor i ndërtimit duhet të jetë i qartë dhe i detajuar, duke përcaktuar objektivat kryesore të projektit, si ndërtimi i një infrastrukture të përshtatshme për klinikën ortopedike, përmbushja e kërkesave funksionale, dhe sigurimi i kushteve për shërbime mjekësore;
 - Plan i ideor duhet të përfshijë të gjitha kërkesat e nevojshme për funksionimin e klinikës, si ndarja e hapësirave për trajtime, shërbime mjekësore, dhe logjistikë (dhoma për pacientët, laboratorë, hapësira për stafin mjekësor, etj);
 - Plan i detajuar duhet të përfshijë infrastrukturën e nevojshme për mbështetje si: uji, energjia elektrike, ngrohja, ventilimi adekuat, sistemet e ujërave të zeza, dhe siguria e pajisjeve teknologjike;
 - Për çdo ndryshim të mundshëm të pozicioneve në planin ideor dhe detajuar, duhet që paraprakisht komisioni vlerësues të jap arsyetimin e nevojshëm për ato ndryshime të dokumentuara qartë, si dhe këto ndryshime duhet të jenë të aprovuara nga menaxhmenti;
 - Stafi përgjegjës duhet të siguroj se ka një sistem të qartë dhe të rregullt për monitorimin e punimeve gjatë realizimit të projektit. Kjo përfshinë vlerësimin e avancimit të punimeve sipas planit të projektit dhe raportimin mbi progresin në mënyrë periodike;
 - Afatet e caktuara për çdo fazë të projektit duhet të respektohen si dhe për çdo vonesë të mundshme ato të jenë identifikuar me kohë. Po ashtu, duhet të shqyrtojë nëse këto vonesa janë raportuar dhe trajtuar në mënyrë të duhur;
 - Për të menaxhuar një projekt mirë dhe për të arritur objektivat e caktuara, menaxhmenti duhet të siguroj që projekti në fjalë është realizuar brenda afateve të përcaktuara në kontratë, janë menaxhuar në mënyrë efikase kërkesat për ndryshime që mund të kenë ndikuar në afatin e përfundimit dhe çmimin e projektit si dhe shpenzimet janë brenda kufijve të përcaktuar në kontratë;
 - Për të qenë një kontratë e suksesshme përveç tjerash plani dhe specifikimet teknike duhet të jenë shumë të qarta dhe konkrete në mënyrë që të sigurohet se:
 - a) janë përdorur materialet dhe produktet e specifikuara në kontratë dhe në përputhje me kërkesat teknike;
 - b) është përmbushur plani dhe dizajni teknik i caktuar në kontratë për projektin e ndërtimit;
 - c) janë instaluar dhe janë funksionalizuar sipas specifikimeve teknike sistemet kryesore të klinikës (p.sh., sistemet e energjisë elektrike, ngrohjes dhe ftohjes, ujit, sistemet mjekësore);
 - d) është përfunduar projekti duke siguruar që të gjitha specifikimet teknike janë përmbushur dhe objekti është funksional dhe i gatshëm për përdorim.
-

- Vlerësimi i përmbushjes së afateve kohore të përcaktuara në kushtet e veçanta të kontratës është një proces për të siguruar realizimin e kontratës brenda periudhës së caktuar. Ky proces përfshin monitorimin e progresit të kontratës dhe identifikimin e shkaqeve të mundshme të vonesave, si dhe vlerësimin e zbatimit të kushteve/klauzolave të kontratës që lidhen me ekzekutimin e penalltive në rast se ka vonesa.
- Vlerësimi bëhet përmes menaxherit të kontratës ose organit mbikëqyrës, duke siguruar që afatet e përcaktuara të respektohen dhe se çdo ndryshim është menaxhuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe kontraktuale.
- Vlerësimi financiar i performancës së kontratës nëse kishte një monitorim të rregullt të buxhetit në raport me shërbimet/punët e përfunduara dhe nëse janë raportuar ndryshime të mundshme të çmimeve të kontraktuara paraprakisht.

Metodologjia e auditimit dhe fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi është i tërë procesi i ndërtimit të klinikës së Ortopedisë, nga fillimi në vitin 2018, ku është bërë deklarata e nevojave për ndërtimin e klinikës, vlerësimi i nevojave dhe planifikimi fillestar, e deri te pranimit teknik i objektit. Fillimisht planifikojmë të analizojmë vlerësimin e nevojave dhe buxhetimit të tij; planin detal dhe specifikacionet e kontraktuara; menaxhimi kohor i punëve; menaxhimi i kontratës dhe pagesave të realizuara si dhe vlerësimi i performancës së kontratës.

Ky auditim ka mbuluar periudhën 2018-2024, pra të gjitha procedurat e realizuara të prokurimit (katër procedura) si dhe gjithë dokumentacionin relevant për këtë projekt. Ky auditim është fokusuar në planin projektues ideor, menaxhimin kohor në përgjithësi, specifikacionet teknike dhe arsyet e vonesave gjatë kryerjes së punëve.

Metodologjia jonë e auditimit përbëhet nga një numër metodash të cilat janë listuar më poshtë, për ta përcaktuar nëse ndërtimi/mbindërtimi i ndërtesës së Ortopedisë është bërë në mënyrën më të mirë të mundshme. Për të siguruar se informatat dhe analizat që kanë dalë nga ky auditim të jenë të sakta, jemi fokusuar në krijimin e një dizajni të mirë të auditimit që ka nxjerrë në pah mangësitë e performancës së entitetit.

Qasja jonë e auditimit për ndërtimin e ndërtesës së Ortopedisë përfshinë një numër të teknikave të cilat do t'i përdorim për të siguruar dëshmi dhe siguri të auditimit, ndër to janë:

- Rishikimi i dokumentacionit, si procedurat e prokurimit për katër kontratat që ndërlidhen me projektin që është subjekt i auditimit, si inicimi i kërkesës, krahasimi i planit të prokurimit me kontratat e nënshkruara, procedurat e prokurimit, për ndërtim/mbindërtim, për mbikëqyrje të projektit, si dhe procedurat e prokurimit për punët e paparashikuara për ndërtimin/mbindërtimin e Ortopedisë, duke filluar nga kërkesa e njësisë kërkuuese e deri te nënshkrimi i kontratave, krahasimin e ditarit ndërtimor të punëve me situacionet e përfunduara krahas afateve kohore të planit dinamik.
- Shqyrtimi i kërkesës iniciuese, ligji i prokurimit dhe rregulloret e fushave përkatëse, për të përcaktuar nëse gjithçka është bërë siç duhet në pajtim me të njëjtat.

- Mbajtja e intervistave me personelin e përfshirë në këtë projekt dhe palëve tjera eventuale të interesit, për të sqaruar proceset dhe si kanë shkuar gjërat, sikurse menaxherët e kontratave dhe palët tjera relevante, për të siguruar informata në lidhje me vonesat e identifikuar.
 - Analizimin e raporteve të pranimi të punëve si dhe krahasimi me gjendjen reale në terren, ku kemi krahasuar artikujt në paramasa kundrejt artikujve të vendosur/ndërtuar në ndërtesë të ortopedisë.
 - Analizimi i kushteve të lejes së ndërtimit dhe krahasimi i tyre me kërkesat ligjore.
 - Analizimin dhe krahasimi i paramasave të çmimeve të kontratave të zbatuara si dhe ofertuesit të dytë më të lirë.
 - Analizimi dhe krahasimi i pagesave të realizuara me kontratat.
 - Raportet për vlerësimin e performancës së kontratave (nëse janë realizuar).
-

Shtojca 2. Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-(SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës- Universitetski Klinicki Centar
Kosova – University Clinical Center of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS
SHKURTËRJA E SHËRBIMIT SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS
KURTAZJA E SHËRBIMIT SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS
HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO
ARKIVI QENDRORE - CENTRALNI ARHIV - CENTRAL ARCHIVE

Thirrja e origjinalit
Kopje e origjinalit
Kopje e origjinalit

Nr. Prot. 6626
Braj. prot. 6626
Prot. no. 6626
Data 01.08.25
Datum 01.08.25
Date 01.08.25



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës
“Efikasiteti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës në ndërtimin e objektit të Klinikës së Ortopedisë”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:
Prishtinë: 31.07.2025

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Efikasiteti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës në ndërtimin e objektit të Klinikës së Ortopedisë” (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Drejtori i QKUK-së
z. Osman Hajdari



An architectural rendering of a modern, three-story office building with a white, grid-patterned facade and large black-framed windows. The building is situated on a street corner with a paved sidewalk and a green lawn area in front. Several trees with green foliage are planted along the sidewalk. A few people are shown walking on the sidewalk, and a car is parked on the street. The sky is blue with scattered white clouds.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës